



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 4.2.2025

Nr: 61

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E RAPORTIT MBI VEPRIMTARITË PUBLIKE PËR PERIUdhËN 26
JANAR – 01 SHKURT 2025**

Sot, më datë 4.2.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

OBJEKT: Shqyrtimi i raportit mbi veprimtaritë me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 26 janar deri më 01 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

V E N D O S:

1. Miratimin e raportit të gjetjeve mbi veprimtaritë publike për periudhën 26 janar deri më 01 shkurt 2025, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Pukë.
3. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Zyrës Vendore Arsimore Peqin.
4. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Librazhd.
5. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
6. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.

Data: 4.2.2025 Nr: 61
Ora: 10:00



“Për shqyrtimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 26 janar – 01 shkurt 2025”

7. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



RAPORTI I GJETJEVE

MBI

VEPRIMTARITË ME KARAKTER PUBLIK TË DISA INSTITUCIONEVE, PËR PERIUDHËN 26 JANAR-01 SHKURT 2025

Në lidhje me raportimet e veprimtarive publike në Ndërfaqen e Raportimeve të Institucioneve (NRI), për periudhën 26 janar – 01 shkurt 2025, konstatohet si vijon:

- 27 institucione publike të reja janë regjistruar gjatë kësaj periudhe në NRI, dhe kanë akses për raportimin e veprimtarive,
- **299 raportime** janë kryer **në total**,
- 294 postime janë aktive,
- **5** janë të ndaluara,

Për datat **26 janar-01 shkurt 2025**, në ndërfaqen e raportimeve janë ndaluar **5** veprimtari të raportuara nga **5** institucione, për shkak të tejkalimit të afatit ligjor, si më poshtë vijon:

- **Bashkia Pukë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - “Përmbledhje e veprimtarisë së organizuar në Michigan USA, me rastin e dorëzimit të titujve vendor të nderit, akorduar me VKB, me 27.12.2024 për personalitete të artit, kulturës dhe gazetarisë Pukjane dhe më gjerë”, raportuar në datën 30.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 31.1.2025.
- **Zyra Vendore Arsimore Peqin** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - Drejtësi “U zhvillua një takim informues me gjimnazistët e gjimnazit "Zihni Magani" Peqin lidhur me pushtetin Legjislativ, funksionet e tij, sa transparent është”, raportuar në datën 28.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 28.1.2025.
- **Bashkia Librazhd** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - Çështje sociale, “Diskutim mbi projekte me karakter social-ekonomik me OJQ”, raportuar në datën 27.01.2025 për t’u zhvilluar në datën 31.01.2025

- **Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - Rend Publik, “Më datë 31.1.2025 ora 14.00, do të zhvillohet analiza vjetore e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, ndër të cilët të ftuar do të jenë dhe Drejtues të Institucioneve të Pushtetit Vendor”, raportuar në datën 27.01.2025 për t’u zhvilluar në datën 31.01.2025,
- **Drejtoria Vendore e Policisë Fier** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - Rend Publik, “Në datë 1.2.2025, ora 14:00, në DVP Fier do të zhvillohet Analiza Vjetore e Punës së kësaj drejtorie, me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Do të jenë të ftuar: Prefekti i Qarkut, Fier, Drejtuesi i Prokurorisë Fier, Kryetari i Gjykatës Fier dhe Drejtori i SHISH Fier. E pranishme do të jetë dhe media lokale”, raportuar në datën 27.1.2025 për t’u zhvilluar në datë 1.2.2025.

Nga dorëzimi periodik i raporteve të monitorimit të dorëzuar për periudhën 22.1.2025 – 1.2.2025, janë administruar:

- 83 raporte monitorimi nga 96 monitorues;
- 13 raporte monitorimi janë kthyer monitoruesve për arsye plotësimi me dokumentacionin provues mbi gjetjet.

Nga 83 raportet e monitorimit janë identifikuar zyra të hapura nga partitë politike si më poshtë vijon:

- Partia Mundësia – 4 zyra të hapura;
- Partia Socialdemokrate – 2 zyra të hapura;
- Partia Socialiste e Shqipërisë – 6 zyra të hapura;
- Partia Demokratike – 1 zyrë të hapur;
- Partia Lëvizja Bashkë – 1 zyrë të hapur.

Gjithashtu nga shqyrtimin i raporteve rezulton se kanë zhvilluar aktivitete partitë si më poshtë vijon:

- Partia Socialiste e Shqipërisë – 15 aktivitete;
- Partia Demokratike – 1 aktivitet;
- Partia e Lirisë – 1 aktivitet.

KQZ është në monitorim të vazhdueshëm të këtij procesi dhe në vijimësi do duhet që të gjithë institucionet shtetërore të kryejnë raportimet në lidhje me veprimtaritë që planifikohen të zhvillohen prej tyre, të paktën 5 ditë para zhvillimit të tyre dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.